



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	08.05.26	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
		10	104/02	-10634

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZËM

THIRRJE PËR APLIKIM

Në programin
“Subvencionimi i bizneseve ekzistuese
mikro dhe të vogla”

08.05.2026

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm (DZHET) në Komunën e Kaçanikut, në bazë të nenit 16 të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve në Komunën e Kaçanikut me nr. 01Nr.05-16-39427/16, në kuadër të Programit " Subvencionimi i bizneseve ekzistuese mikro dhe të vogla " shpallë këtë thirrje për aplikim për mbështetje të bizneseve lokale mikro dhe të vogla.

Qëllimi i Programit "Subvencionimi i bizneseve ekzistuese mikro dhe të vogla", ka për synim fuqizimin ekonomik të bizneseve lokale, përkatësisht promovimin dhe rritjen e tyre.

Ky fond do të nxisë dhe mbështesë zgjerimin e bizneseve për punësim kryesisht te grave dhe të rinjëve.

Interes i veçantë i kushtohet projekteve që kanë mundësi të zëvendësojnë importet dhe të krijojnë eksporte që mbulojnë nevojat dhe prioritetet e mjedisit lokal.

Shuma e fondit në dispozicion për këtë thirrje është 50,000.00 €.

Vlera maksimale e financimit të përbashkët të një granti është 3,000.00 €

- Përqindja e bashkëfinancimit nga aplikantët duhet të jetë 30%, kurse shuma që kërkohet nga Komuna e Kaçanikut nuk mund të jetë mbi 70% e koston totale të projekt propozimit (pra shuma e bashkëfinancimit nga ana e komunës nuk mund të kaloj vlerën 2,100.00 € dhe kosto totale e projekt propozimit nuk duhet të kaloj vlerën 3,000.00€, ndërsa shuma e bashkëfinancimit të bizneseve nuk duhet të jetë më e lartë se 900 €).

KRITERET E APLIKIMIT:

1. Bizneset duhet të jenë të regjistruara në ARBK dhe të operojë në komunën e Kaçanikut, ku edhe duhet të bëhet investimi;
2. Bizneset ekzistuese duhet të jenë ndërmarrje në pronësi private 100% dhe të regjistruara në Kosovë sipas ligjeve të Kosovës;
3. Biznesi duhet të ketë të punësuar së paku një punonjës ose të jetë i vetëpunësuar;
4. Të gjeneroj punësim me marrjen e grantit;
5. Bizneset duhet të dëshmojnë se janë funksionale, të qëndrueshme në treg dhe kanë kapacitet të mjaftueshëm për zgjerimin e prodhimit, qarkullimit dhe rritjen e numrit të punonjësve;
6. Bizneset të cilat promovojnë ide kreative dhe inovative në tregun tonë do të kenë përparësi;
7. Ndërmarrjet të cilat me blerjen e pajisjeve ofrojnë produkte cilësore të cilat ndikojnë në zhvillimin ekonomik kanë përparësi;
8. Në momentin e aplikimit biznesi duhet të dorëzojë Pro faturën /Ofertën për pajisjet dhe mjetet e punës të planifikuara për investim;
9. Vërtetim mbi tatimin në pronë;
10. Bizneset duhet të dëshmojnë se nuk kanë obligime ndaj Administratës Tatimore të Kosovës(ATK);

11. Biznesi duhet të ketë një qarkullim prej 3,000.00€ – 20,000.00€ nga viti i fundit kalendarik, të dëshmuar nga ATK. Bizneset e regjistruara/hapura gjatë fundit të vitit 2025 dhe fillimit të vitit 2026 kanë të drejtë aplikimi me kusht që të dëshmojnë qarkullim minimal prej 750.00€ gjatë TM1 (janar–mars 2026), ndërsa për bizneset e reja që nuk kanë përfunduar një tremujor fiskal (p.sh. të hapura pas marsit 2026), kërkohet dëshmi e qarkullimit të realizuar deri në momentin e aplikimit.

Vërejtje

Aplikimet e bizneseve të regjistruara pas muajit mars 2026 do të shqyrtohen vetëm në rast të mungesës së aplikimeve të mjaftueshme nga bizneset që i plotësojnë kriteret e rregullta të thirrjes.

PËRPARËSITË PËR GRANTET PËR BIZNESET MIKRO DHE TË VOGLA:

	Pikët
Ideja e biznesit dhe inovacioni	Totali(55 pikë)
Idetë inovative	15 pikë
Bizneset Prodhuuese dhe Përpunuese	15 pikë
Bizneset Shërbyese	10 pikë
Potenciali për eksport	10 pikë
Potenciali për adresimin e një nevoje ose një problemi real	5 pikë
Potenciali i tregut dhe përvoja e aplikuesit	Totali(23 pikë)
Madhësia e tregut dhe potenciali i rritjes	10 pikë
Avantazhi konkurrues dhe diferencimi	8 pikë
Përvoja dhe aftësitë përkatëse të aplikuesit	5 pikë
Ndikimi social dhe mjedisor	Totali(22 pikë)
Aplikuesi/ja është me aftësi të kufizuara	6 pikë
Aplikuesi/ja është i gjinisë femërore	6 pikë
Projekti ka ndikim pozitiv në ambient	5 pikë
Aplikuesi është i moshës 18 deri në 30 vjeç	5 pikë
	TOTALI : 100 Pikë

PROCEDURAT E VLERËSIMIT:

Faza e parë e vlerësimit të aplikacioneve do të përfshijë një “kontroll administrativ” për të siguruar që aplikantët kanë përmbushur rregullat e kualifikimit dhe dokumentet e kërkuara për aplikim. Faza e dytë dhe përfundimtare përfshinë vlerësimin përmbajtësor të aplikimit duke u bazuar në kriteret përzgjedhëse dhe nëse ndërmarrja ka perspektivë të mirë të qenit e suksesshme dhe e qëndrueshme, si dhe që implementimi do të kontribuojë drejt përmbushjes së qëllimit të thirrjes për grante. Pas vlerësimit aplikantët do të renditen sipas pikëve të fituara. Aplikuesit që arrijnë minimumi 50 pikë konsiderohen të kualifikuar për përfitim të grantit, ndërsa aplikuesit me më pak se 50 pikë refuzohen. Bazuar në shumën totale të fondit

në dispozicion prej 50,000.00 €, në kuadër të kësaj thirrjeje do të përzgjidhen maksimalisht 24 përfitues me pikët më të larta. Aplikuesit e tjerë që kanë arritur pragun minimal prej 50 pikësh, por që nuk janë përzgjedhur për shkak të kufizimit të numrit të përfituesve, do të vendosen në listë të pritjes dhe mund të përfitojnë në rast të tërheqjes së ndonjë përfituesi ose sigurimit të mjeteve shtesë financiare nga Komuna e Kaçanikut gjatë vitit 2026.

ÇFARË FINANCOHET NGA GRANTI:

Blerja e pajisjeve dhe mjeteve të punës (Pajisjet duhet të jenë të reja).
Investime në asete të prekshme që kanë të bëjnë me blerjen e pajisjeve, makinerisë, linjat e prodhimit, që mund t'i ndihmojnë kompanive të jenë më pak të varura nga faktorët e jashtëm.

KRITERET JOKUALIFIKUESE:

Aplikantët potencialë nuk mund të marrin pjesë në këtë thirrje apo të përfitojnë grant nëse gjenden në ndonjërin prej situatave që renditen si më poshtë:

- Bëjnë pjesë në njërin prej veprimtarive si: tregtia (me pakicë e shumicë, në kuptimin e shit-blerjes), ndërtimtaria, bujqësia, gastronomia;
- Paraqet veti diskriminuese apo ka ndikim negativ në shoqëri dhe komunitet;
- I shkakton dëme ambientit apo ndonjë grupi tjetër të marginalizuar;
- Përfituesit e subvencioneve të ndara nga Komuna e Kaçanikut gjatë viteve 2023,2024,2025,2026 nuk kanë të drejtë aplikimi.

PROCEDURA E APLIKIMIT

Pakoja e Aplikimit mund të merret duke klikuar në ueb-faqen zyrtare të komunës në linkun:
<https://kacanik.rks-gov.net/shpalljet/>.

Pasi ta keni plotësuar aplikacionin, së bashku me dokumentacionin mbështetës që kërkohet, duhet të dorëzohet në formën fizike në Qendrën për Shërbim me Qytetar në objektin e komunës së Kaçanikut në katin përdhës, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Dokumentet duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur.

AFATI I APLIKIMIT:

Periudha e aplikimit do të jetë e hapur nga **08.05.2026** deri më **29.05.2026**.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

Pakoja e aplikimit e përmbanë dokumentet si në vijim:

- Formulari i aplikimit ;
- Deklarata nën betim nga aplikanti ;
- Kopje e letërnjoftimit;
- Kopje e Certifikatës së Biznesit me të gjitha informatat përcjellëse;
- Oferta / Profatura me të gjitha shënimet e duhura si: numri i regjistrimit të biznesit, numri i pro faturës, emri i plotë i furnitorit (shitësit), adresa e saktë , nënshkrimi dhe vula e shitësit, dhe të gjitha të dhënat tjera të rëndësishme për furnitorin ku do të blihet pajisja/et, specifikacionin e pajisjeve apo mjeteve të punës me çmimin përkatës. Oferta duhet të ketë datën e saj pas publikimit të kësaj thirrje ;

- Konfirmimi Bankar i Biznesit;
- Vërtetim mbi tatimin në pronë
- Dëshmi nga gjykata kompetente që dëshmon se aplikuesi nuk është nën hetime
- Vërtetimi tatimor me validitet në ditën e aplikimit (jo më i vjetër se 90 ditë) me të cilin vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime të tjera tatimore, ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK-në ;
- Lista e punëtorëve për vitin e (2025/2026) të lëshuar nga ATK ;
- Raporti i qarkullimit vjetor ose dëshmi e të ardhurave bruto të lëshuara nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), apo deklaratimet periodike të pranuar nga ATK, që dëshmojnë të ardhurat për vitin fiskal 2025. Bizneset e regjistruara gjatë fundit të vitit 2025 dhe fillimit të vitit 2026 duhet të dëshmojnë qarkullimin minimal prej 750.00€ përmes TMI (janar–mars 2026), ndërsa për bizneset e regjistruara pas muajit mars 2026, kërkohet dëshmi e qarkullimit të realizuar deri në momentin e aplikimit.

FORMA E PAGESËS SË GRANTIT:

Grantet jepen në formën e transferit të mjeteve financiare, pasi që biznesi sjellë dëshminë dhe faturën e rregullt për blerjet (investimet) që ka bërë, të cilat duhet të jenë në përputhshmëri të plotë me kërkesën për investim që e ka dëshmuar me pro faturë/ofertë. Pro fatura që biznesi e paraqet gjatë aplikimit dhe fatura e rregullt që biznesi e merr pas blerjes së pajisjes duhet të kenë përputhshmëri të plotë ndërmjet tyre, por në rast të ndryshimit të çmimeve nga momenti i dorëzimit të pro faturës deri në realizimin e blerjes, fatura përfundimtare mund të ndryshojë. Në rast të rritjes së çmimeve, diferenca mbulohet nga përfituesi, ndërsa bashkëfinancimi i Komunës së Kaçanikut mbetet i pandryshuar dhe nuk tejkalon 70% të vlerës së aprovuar. Në rast të uljes së çmimeve, bashkëfinancimi i Komunës rillogaritet në përputhje me përqindjen e miratuar (deri në 70%) mbi vlerën reale të faturës përfundimtare, pa e tejkaluar shumën e aprovuar.

Sqarim: Në rast se jeni përzgjedhur përfitues i grantit, nënshkruhet marrëveshja me Komunën/DZHET dhe pastaj duhet të sjellët **Fatura dhe transferi bankar** i bërë nga xhironlogaria e biznesit tuaj tek operatori ekonomik (furnitori), me të cilën dëshmohet blerja e pajisjes/ve dhe pastaj Komuna e bënë rimbursimin e mjeteve financiare në vlerën e grantit.

Kohëzgjatja e planifikuar e zbatimit pas nënshkrimit të marrëveshjes nuk mund të tejkalojë 2 muaj.

Vërejtje: Nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes me secilin përfitues, përfituesi është i obliguar që t'i përmbahet kushteve të marrëveshjes, vlen të ceket që përfituesi nuk ka të drejtë që pajisjen ta ndërroj, shesë apo të huazoj tek pala tjetër në afate kohor prej 3 vite duke filluar nga data e nënshkrimit të marrëveshjes. Pas nënshkrimit të marrëveshjes për secilin përfitues, formohet komisioni nga ana e Komunës së Kaçanikut, komisioni i cili monitoron gjendjen faktike në teren dhe në rast të keqpërdorimit eventual do të ndiqen rrugët ligjore.

Drejtoreshë e DZHET

Arlinda Rakoci-Raka

